

Produkti
I RI!



Vetitë dhe avantazhet

- Teknologji e provuar dhe e besueshme e baterive plumb-acid, me elektrodë pllakë të zhytur në elektrolit
- E shkëlqyer për aplikime me shkarkime të shpejta
- Kuti me madhësi sipas standardit të industrisë
- Diapazon i gjerë Amper-orë: 55Ah deri 1000Ah ($C_{10}/1,80V_{pc}/20^{\circ}C$)
- Mundësi për zgjedhje blloqesh 2, 6 dhe 12 volt
- Jetëgjatësi e lartë funksionimi
- Intervalet e mbushjes: rreth 3 vjet në funksion gatishmërie në $20^{\circ}C$
- Diapazon gjithëpërfshirës i temperaturës së funksionimit
- Të gjitha bateritë disponohen të mbushura dhe të karikuara
- Përputhshmëri me standardin DIN 40737-3 (përmasat) standarde

Bateria

Përmbledhja e gamës

Bateritë PowerSafe® OGi të EnerSys® janë bateri klasike plumb-acid me ajrim, ideale për aplikime me kriterë të larta sigurie dhe me norma të larta shkarkimi të tilla si sistemet UPS. Teknologjia PowerSafe e OGi është përshtatur në mënyrë të përkryer për orë më të gjata shkarkimi në telekom, në industrinë e shërbimeve dhe të energjive të rinovueshme.

Modeli i veçantë i pllakave në formë shkopi të PowerSafe OGi, i njohur mbi 35 vjet për EnerSys, ofron një dendësi të lartë energjie që çojnë në kursime të mëdha të hapësirës së nevojshme, në jetëgjatësi të madhe në shërbim dhe aftësi të mira ciklike në kuti me madhësi standarde të industrisë. Për më tepër, aliazhi i plumbit me përqindje të ulët antimoni (Sb) redukton intervallat e mbushjes me ujë dhe, rrjedhimisht, kostot e mirëmbajtjes.

Konstruksioni tubolar dhe aliazhi i skarës reduktojnë intervallat e mirëmbajtjes dhe kostot, ndërkohë që kutitë transparente e bëjnë më të lehtë inspektimin pamor. Konstruksioni me integritet të lartë i kontaktit maksimalizon sigurinë funksionale dhe e bën më të shpejtë dhe të lehtë leximin e matjeve të tensionit dhe rezistencës.

Konstruksioni

- Elektroda pozitive - Pllakë shufër me aliazh plumbi të varfër në antimon. Dizajni i provuar dhe struktura radiale e rrjetës sigurojnë sjellje superiore afatgjatë
- Elektroda negative - pllaka të sheshta të ngjitura që sigurojnë ekuilibër perfekt me pllakat pozitive për të garantuar performancë maksimale
- Veçimi – veçues mikroporoz i veçantë, i kombinuar me fibra qelqi
- Kutia – E derdhur me akrilonitril stireni (SAN) të tejdukshëm, të fortë, dhe shumë rezistent ndaj goditjes që lejon monitorimin me sy të nivelit të elektrolitit dhe gjendjes së pilës
- Material i kapakut i përbërë prej polimeri ABS të fortë dhe të patejdukshëm. Të ngjitura hermetikisht me kutinë për të mos lejuar rrjedhje të elektrolitit
- Elektroliti - Acidi sulfurik i holluar me peshë specifike 1, 240 (niveli maksimal) për performancë afatgjatë dhe të besueshme
- Dizajni i terminalit - Hermetik, femër M10, pol të sigurt me unazë tunxhi
- Tapat e shkarkimit – Dizajn i provuar, me integritet të lartë. Të pajisura me bllokues flake për më shumë siguri
- Lidhësit – lidhës fleksibël i kablove ndërmjet blloqeve. Unaza në skajet e kablove për matjen e tensionit

Instalimi dhe funksionimi

- Tensioni i karikimit plotësues: 2.23 Vpc në 20°C
- Diapazoni i lejuar i temperaturës së funksionimit: -10°C deri +45°C
- Sipërfaqe e vogël e kërkuar për instalim për shkak të dendësisë së lartë të energjisë
- Gamë e gjerë raftesh, përfshirë raftet sizmike, të disponueshme me porosi

Standardet

- Projektuar për t'u përpunuar me kërkesat e standardit ndërkombëtar IEC 60896-11
- Projektuar për t'u përpunuar me standardin DIN 40737-3 (ka të bëjë specifikisht me përmasat)
- Produkte duhet të instalohen në përpunje me EN 50272-2, IEC 62485-2 dhe rregulloret e brendshme

Specifikimet e përgjithshme

	Tensioni (V)	Kapaciteti nominal (Ah)	Përmasat nominale (mm)			Pesha tipike (Kg)
		C ₁₀ në 20°C deri 1,80Vpc	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	
12 OGi 60	12	55	272	205	385	30,0
12 OGi 80	12	83	272	205	385	45,0
12 OGi 110	12	111	272	205	385	55,0
12 OGi 140	12	139	380	205	385	69,0
12 OGi 170	12	166	380	205	385	84,0
6 OGi 200	6	194	272	205	385	49,0
6 OGi 230	6	222	272	205	385	56,0
6 OGi 250	6	250	380	205	385	63,0
6 OGi 280	6	278	380	205	385	68,0
6 OGi 300	6	305	380	205	385	76,0
6 OGi 330	6	333	380	205	385	83,0
2 OGi 670	2	667	272	205	385	58,0
2 OGi 830	2	834	380	205	385	69,0
2 OGi 1000	2	1000	380	205	385	83,0

Vizatimet e kontureve

